



Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës

~ Vit i arritjeve ~

Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008. Kjo ditë historike shënoi filltet e një realiteti të ri në Kosovë, si dhe nevojën për institucione të reja, duke përfshirë Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Më 15 qershor 2008 hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe, bashkë me të, edhe Ligjet mbi Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. NATO, me këtë rast, themeloi edhe Ekipin Këshillues të NATO-s për ta mbështetur zhvillimin e Ministrisë.

Më 4 gusht 2008, Fehmi Mujota u emërua Ministri i parë dhe Dr. Shkelzen Syla u caktua ta ushtrojë detyrën e Sekretarit të Pëthershëm, duke nisur kështu Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në mënyrë efektive.



Shtator 2008

Ministri mirëpriti vizitën e parë të homologut të tij, Ministrin lituanez të Mbrojtjes, Juozas Olekas.

Kuvendi i Kosovës aprovoi buxhetin e parë për Ministrinë: 746.000 Euro.

Ministri u takua me Komandantin Suprem të Aleancës të NATO-s (SACEUR), Gjeneralin Craddock dhe diskutoi zhvillimin e Ministrisë.

Tetor 2008

Ministri aprovoi strukturën organizative të Ministrisë, ku përfundimisht do të punësohen 106 shërbyes civil dhe 63 pjesëtarë të FSK-së. Ai gjithashtu nënshkroi rregulloren e parë të FSK-së mbi rekrutimin, që paraqet rregulloren e parë ndër 21 të nënshkuara deri tani.

Nëntor 2008

Ministri e njoftoi Këshillin Veri-Atlantik të NATO-s, gjatë vizitës së tyre në Kosovë, mbi përparimin e Ministrisë dhe u takua me Komandantin e Forcave të Përbashkëta, Admiralin Fitzgerald, për ta diskutuar themelimin e Ministrisë dhe rekrutimin.

Dhjetor 2008

U aktivizua faqja e internetit dhe Ministri mbajti një konferencë për shtyp për prezantimin e uniformave, simboleve dhe emblemave të FSK-së.

Z. Behxhet Brajshori u emërua Zëvendës Ministër dhe Lejtnant Gjeneral Sylejman Selimi u emërua Komandant i FSK-së.



Janar 2009

FSK-ja u themelua zyrtarisht në orën 00:01 të 21 janarit. Më shumë se 1400 ish-pjesëtarë të TMK-së u përzgjedhën për FSK-në dhe u ftuan për të marrë pjesë në stërvitje.

Në të njëjtën kohë filloi edhe fushata e gjithëmbarshme kosovare e rekrutimit, me ç'rast konkurruan rreth 4900 kandidatë për pak më shumë se 400 pozita të punës.

Shkurt 2009

Trajnimi filloi për 254 pjesëtarët e parë të FSK-së dhe Ministri e pranoi grupin e parë nga 204 automjetet të cilat i dhuroi qeveria gjermane. Ministri e njoftoi dhe dha një prezantim para Grupit Drejtues Ndërkombëtar (GDN-ISG) në Vjenë



Prill 2009

Ministri dhe Komandanti i FSK-së vizituan Turqinë për t'u takuar me Ministrin e Mbrojtjes të Turqisë, Vecdi Gonul.

Maj 2009

Ministri nëshkroi Memorandumin e parë të Mirëkuptimit për bashkëpunim në fushën e sigurisë me Mbretërinë e Bashkuar.



Qershor 2009

Oficerët e FSK-së me gradë të Gjeneralëve dhanë Betimin në praninë e Presidentit, Kryeministrit, Ministrit dhe Komandanti i FSK-së.

Grupi i parë prej 106 rekrutëve të ri përfunduan stërvitjen dhe u bënë pjesëtarë të FSK-së



Korrik 2009

Ministri u takua me SACEUR-in e ri të NATO-s, Admiralin James Stavridis. Ata biseduan rreth suksesit të ministrisë gjatë vitit të kaluar dhe përparimin e vazhueshëm në themelimin e FSK-së.

